

KPA largon përfundimisht nga sistemi i drejtësisë gjyqtarin Fehmi Petku

Kolegji i Posaçëm i Apelimit e ka vlerësuar të drejtë vendimin e Komisionit për shkarkimin e ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Fehmi Petku, i cili u shkarkua për probleme në të tri kriteret.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Ish-kryetari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Fehmi Petku, duke dalë nga një seancë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK. Foto:LSA

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, KPA vendosi të mërkurën të rrëzojë ankimin e ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Fehmi Petku kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që e shkarkoi për shkelje të shumta në të tri kriteret e rivlerësimit.

Në njoftimin e KPA thuhet se trupi gjykues i Kolegjit, i përbërë nga Albana Shtylla kryesuese, Natasha Mulaj relatores, Ardian Hajdari, Ina Rama dhe Sokol Çomo anëtarë, në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, në mënyrë unanime, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 136 të 9 prillit 2019 të KPK për shkarkimin e ish-gjyqtarit Fehmi Petku nga detyra.

Petku u shkarkua me vendim të shumicës së anëtarëve të Komisionit e përfaqësuar nga Pamela Qirko dhe Genta Tafa Bungo, me arsyetimin se kishte bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, ka ndërmarrë hapa për të evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij, është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar për shkak të mundësisë për vënien e tij nën

presion nga strukturat kriminale, si dhe ka cënuar rëndë besimin e publikut të drejtësia.

Anëtarja e trupit gjykues, Xhensila Pine paraqiti mendim paralel, edhe pse votoi në favor të shkarkimit të gjyqtarit Fehmi Petku. Ajo e kundërshtoi shumicën për sa i përket papërshtatshmërisë së gjyqtarit për të vazhduar detyrën. Sipas Pines, gjetjet e Komisionit për sa i përket pastërtisë së figurës së subjektit “nuk janë shkaqe që përligjin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.”

Petku e filloi karrierën në sistemin e drejtësisë në vitin 1994. Ai ka punuar pranë Gjykatës së Tiranës përgjatë viteve 2000-2009 dhe më pas në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Në vitin 2015, Petku u emërua kryetar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Me vendimin e të mërkurës, më 16 shtator KPA e largoi përfundimisht Petkun nga sistemi i drejtësisë.



RRETH AUTORIT

[Edmond Hoxhaj](#)

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.